



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 322, Datë 14.11.2023

MBI

**DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË
SHOQËRISË “KARAVASTA SOLAR” SH.P.K. SI MJET (BARRË SIGURUESE) PËR
GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, 8, 9, pikat 4 dhe 5 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.11.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2360/2 prot., datë 09.11.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese) për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2306 prot., datë 17.10.2023, paraqiti aplikimin për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimeve të palës huamarrëse (shoqërisë “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k.) ndaj Palës Huadhënëse (e përbërë nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. dhe Privredna Banka Zagreb – Diončko Društvo), ku shoqëria Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. vepron si Agjenti i Mjeteve të Ekzekutimit të Detyrimeve Onshore, në zbatim të Marrëveshjes për Kushtet e Përbashkëta (nënshkruar më 23.07.2023) dhe Marrëveshjes për Barrën Siguruese mbi Kuotat (nënshkruar më 13.10.2023).
- Shoqëria “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 98, datë 09.05.2022.

- Nga analizimi i aplikimit rezulton se shoqëria “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k., plotëson kërkesat e *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollojnë interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollojnë interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, si vijon:
 - **Neni 8, pika 1**, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. **Plotësuar**
 - **Neni 8, pika 2**, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. **Plotësuar.**
- Shoqëria “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj ERE-s për sa i përket pagesave rregullatore.
- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
- Për sa parashikuar në marrëveshjen e barrës siguroese, por dhe për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi kuotat për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësojmë që t’i lihet kusht shoqërisë “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. që të njoftojë ERE-n pas shlyerjes së plotë të detyrimit dhe heqjes së barrës siguroese mbi kuotat, ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. si mjet (barrë siguroese) për garantimin e përmbushjes së detyrimeve të saj ndaj Palës Huadhënëse (e përbërë nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. dhe Privredna Banka Zagreb – Diončko Društvo), ku shoqëria “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. vepron si Agjenti i Mjeteve të Ekzekutimit të Detyrimeve Onshore.
2. Dhënia e autorizimit nga ERE, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
3. Shoqëria “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. të njoftojë ERE-n pas shlyerjes së plotë të detyrimit dhe heqjes së barrës siguroese mbi kuotat e saj, ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI